



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**  
Rruga: Naim Frashëri, Nr 37, Tiranë, SHQIPËRI

---

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E**  
**SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT**  
**TË MËSUESVE TË GJIMNAZIT, FUSHA ARTE, LËNDËT:**  
**ART PAMOR, KËRCIM, MUZIKË DHE TEATËR**  
**2013**

**1) HYRJE**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Arteve është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA, për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve që mbulojnë fushën e Arteve, përkatësisht lëndët: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- programet përkatëse lëndore;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi si dhe të fushës së Arteve, përkatësisht lëndët: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër në veçanti;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtjen shkencore të fushës së Arteve, përkatësisht lëndët: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër sipas programeve lëndore përkatëse.

**2) QËLLIMI I PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Arteve është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

---

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të fushës së Arteve, përkatësisht lëndët: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e kompetencave profesionale dhe përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së etikës dhe komunikimit gjatë praktikës pedagogjike.
- Rritjen e kompetencave profesionale për domosdoshmërinë e njohjes së drejtshkrimit dhe gjuhës shqipe gjatë procesit pedagogjik.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### 3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të fushës së Arteve, përkatësisht lëndët: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke patur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të

zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	
Fusha: Dokumentet zyrtare	
Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njohë në mënyrë të veçantë:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>ligjin për sistemin arsimor Parauniversitar;</i></li> <li>- <i>dispozitat normative për arsimin parauniversitar.</i></li> </ul> </li> <li>• të shpjegojë dhe të jetë i qartë për të drejtat dhe detyrat e nxënësit;</li> <li>• të shpjegojë dhe të jetë i qartë për të drejtat dhe detyrat e mësuesit;</li> <li>• të dijë dhe kuptojë funksionin që kanë organet kolegjiale në shkollë;</li> <li>• të kuptojë funksionimin e qeverisë së nxënësve dhe senatit në shkollë;</li> <li>• të zbatojë drejt udhëzimet e ndryshme të dala nga MASH, duke qenë të përgjegjshëm në zbatimin e kërkesave të dokumentacionit shkollor:               <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>“Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve”</i> si dhe</li> <li>2. <i>“Për zhvillimin e orëve të lira”.</i></li> <li>3. <i>“Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor”.</i></li> <li>4. <i>Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore”.</i></li> </ol> </li> <li>• respektojë të gjitha udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji Nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar (DN).</li> <li>• Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve".</li> <li>• Udhëzimi Nr.38 , dt.09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë".</li> <li>• Udhëzimi Nr. 35, dt.09.10.2007 i MASH “Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor”.</li> <li>• Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH “Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore”.</li> <li>• Udhëzim Nr. 16, dt. 24.07.2012 për vitin shkollor 2012-2013 në sistemin arsimor parauniversitar.</li> <li>• Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi i Altertekstit 2010-2011 dhe Paketa informuese “Altertekst 2012”.</li> <li>• Rregullore për procesin e maturës shtetërore 2013 në Republikën e Shqipërisë, dt. 07.01.2013.</li> <li>• Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz.</li> <li>• “Kualifikimi i mësuesve” – Teste 2008, 2009, 2010”, IKT</li> </ul>

**Fusha : Programet lëndore: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër**

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë çfarë kupton me standard përmbajtjeje;</li> <li>• të shpjegojë çfarë kupton me standard arritjeje;</li> <li>• të shpjegojë rrishtë e fushës së arteve dhe si zbatohet ajo në shkollë;</li> <li>• të shpjegojnë ndërtimin e strukturës së programeve të Arteve, në përgjithësi dhe përkatësisht të lëndës që jep (rubrikat);</li> <li>• të shpjegojë ndryshimin midis objektivave të përgjithshëm të lëndës nga objektivat e përmbajtjes – (për lëndën e vet);</li> <li>• të dallojë konceptet kryesore që duhet të japë – (për lëndën e vet);</li> <li>• të dallojë aftësitë që duhet të përftojnë nxënësit përmes programit të lëndës;</li> <li>• të përshkruajë hapat e ndjekura për realizimin e objektivave mësimore;</li> <li>• të planifikojë mjetet e nevojshme për realizimin e orës së mësimi, duke dhënë momentet kur i përdor ato;</li> <li>• të zbërthejë sipas objektivave me tri nivele objektivat e një linje të dhënë nga programi mësimor;</li> <li>• të zbërthejë objektivat e përmbajtjes sipas linjave, duke i përshtatur ato në tema mësimore (plan tematik – modele për një linjë të caktuar të programit);</li> <li>• të vendosë objektivat e orës së mësimi në linjat:             <ul style="list-style-type: none"> <li>• estetikë</li> <li>• elementet dhe parimet</li> <li>• procese të krijimit dhe të realizimit artistik</li> <li>• historia e arteve , bota dhe shoqëria</li> <li>• teknologjia dhe media</li> </ul>             duke u mbështetur në Taksonominë afektive;           </li> <li>• të hartojë një projekt lidhur me një çështje nga lënda.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Korniza Kurrikulare e gjimnazit 2008-IKT.</li> <li>2. Standardet e të nxënit për gjimnazin “Arte” - botim i IKT 2008.</li> <li>3. Programet lëndore të Arteve, gjimnaz, botim 2008- IKT.</li> <li>4. Udhëzues për mësuesit e gjimnazit, për Artet, IZHA, botim 2010.</li> </ol>

**Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie****Rezultati****Mësuesi do të jetë i aftë:**

- të zotërojnë një larmi metodash/strategjish të mësimdhënies efikase në fushën e arteve për lëndën që jep;
- të planifikojë mësimin, bazuar mbi një teknikë apo metodë mësimore;
- të organizojë mësimin bazuar në objektiva për çdo linjë mësimore;
- të hartojë një plan ditari sipas një skeme të caktuar, duke dhënë shpjegimet përkatëse;
- të shpjegojë metodën e bisedës, së kërkimit, punës në grupe, të projektit dhe mënyrën e funksionimit të tyre gjatë orëve të veçanta;
- të shpjegojë metodën me në qendër nxënësin;
- të kuptojë përdorimin e teknikave të tilla të Menduarit Kritik, si: brainstorming, klaster, Diagrama e Venit etj., gjatë mësimdhënies tek Artet, duke i përshtatur sipas lëndës etj;
- të planifikojë mësimin, bazuar mbi një teknikë apo metodë mësimore;
- të shpjegojë teknikat e vlerësimit;
- të planifikojë mjetet e nevojshme për realizimin e orës së mësimin, duke dhënë momentet kur i përdor ato;
- të përdorë medie të ndryshme gjatë mësimdhënies në klasë si: kompjuter, DVD, Cd etj.

**Literatura**

- Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin.
- Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimin, përgatitjen e ditarit të mësuesit, organizimin e orës së mësimin.

**Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit****Rezultati****Mësuesi do të jetë i aftë:**

- të njohë rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;
- të sillen në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe

**Literatura**

- Kodi i Etikës së Mësuesve në Arsimin Parauniversitar publik dhe privat, i datës 12.11.2012.
- Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

jashhtë institucionit arsimor.	
<b>Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b>	
<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të njohë rregullat e drejtshkrimit, të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>të zbatojë rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.</li> </ul>
<b>Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndëve: Art pamor, Kërcim, Muzikë dhe Teatër</b>	
<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<p><b><u>ESTETIKA</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të shpjegojë ç'është estetika: <ul style="list-style-type: none"> <li>Estetika dhe kuptimi i saj</li> <li><i>cilësitë estetike</i></li> <li><i>artet e thjeshta dhe të përbëra</i></li> <li><i>etj.;</i></li> <li>Artet dhe mjetet shprehëse</li> <li>Vetitë e tingujve përmes estetikës në muzikë: lartësia, gjatësia, ngjyra, timbri;</li> <li>Etj.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tekste shkollore, materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.</li> </ul>
<p><b><u>ARTI PAMOR</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të demonstrojë njohuri të qëndrueshme në artin pamor dhe të sakta shkencërisht;</li> <li>të shpjegojë teoritë e kritikës së artit, e bukura, artet e thjeshta dhe të përbëra, përfaqësuesit më të mëdhenj të estetikës dhe teoritë e tyre;</li> <li>të shpjegojë elementet dhe parimet, duke i evidentuar ato në vepra të ndryshme arti;</li> <li>të shpjegojë proceset e realizimit artistik në artin pamor. <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Mjete dhe teknika të vizatimit</i></li> <li><i>Mjete dhe teknika të pikturës</i></li> <li><i>Mjete dhe teknika të printimit</i></li> <li><i>Fotografia</i></li> <li><i>Proceset dhe materialet e skulpturës si: modelimi, gdhendja, derdhja, asemblazhi.</i></li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tekste shkollore, materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.</li> </ul>

- të japë udhëzime për krijimin e një eseje për një vepër ose veprimtarinë e një artisti (stilin e tij, periudhën kur ka punuar, problematikën që ai ka trajtuar në punën e tij etj);
- të udhëheqë një projekt kërkimor për një periudhë të caktuar në historinë e artit. (nga historia e artit botëror apo shqiptare);
- të shpjegojë saktë vlerat e artit botëror dhe përfaqësuesit e tyre:
  - *Arti prehistorik, arti në mesopotami, arti egjiptian, arti egje, arti grek, arti romak, kristianizmi i hershëm, arti bizantin, përfaqësuesit dhe veprat e tyre.*
  - *Arti islamik, arti kinez, qytetërimet e hershme në Amerikë.*
  - *Arti në mesjetë, mesjeta e hershme, arti romanik, arti gotik,*
  - *Arti në rilindje, gotiku i vonë, rilindja e pare, rilindja e lartë, manierizmi, baroku, rokoko.*
  - *Neoklasicizmi, romanticizmi, realizmi, impresionizmi, postimpresionizmi, avangardat artistike, arti në shekullin XX.*
- të shpjegojë saktë vlerat e artit shqiptar dhe përfaqësuesit e tyre:
  - *Arti shqiptar (kultura ilire), arti grek i kolonive (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu) mozaikët e lashtë në Shqipëri.*
  - *Onufri, arti në Shqipëri- ikonografët e shekullit XVIII.*
  - *Arti në Shqipëri- periudha e rilindjes dhe periudha e pavarësisë, realizmi socialist në Shqipëri.*

## **KËRCIM**

*Baleti në Evropë gjatë shek. XVII – XVIII:*

- zhvillimi i mëtejshëm i kërcimit,
- shkollat dhe koreografët italianë dhe francezë,
- tiparet kryesore.

*Epoka e Noverit:*

- Reformat e Zhan Zhak Noveri,
- baletet kryesore të Nover.

*Romantizmi dhe tiparet e tij në kërcim:*

- Botëkuptimi romantik;
- Baleti i parë romantik;
- Koreografët, kërcimtarët dhe kompozitorët më të njohur të romantizmit.

*Baleti Rus në shek. 20 dhe baletet e para simfonike:*

- Zhvillimi i baletit rus;
- “Rilindja” e kërcimit klasik;
- Marius Petipa dhe P.I.Çajkovski;
- Anterpriza e S.Djagilievit.

*Kërcimi klasik në shek. XX dhe format kryesore të tij:*

- Kërcimi Klasik në Evropë;
- Kërcimi Klasik në Amerikë;
- Format e baleteve;
- Përfaqësuesit më të njohur.

*Lindja e kërcimit modern dhe përfaqësuesit e tij:*

- Lindja e kërcimit modern në Amerikë;
- Zhvillimi i tij në Evropën Perëndimore;
- Shkollat kryesore;
- Përfaqësuesit.

*Baleti në Shqipëri:*

- Lindja e baletit në Shqipëri;
- Pedagogët dhe kërcimtarët e parë;
- Krijimi i shkollës dhe trupës profesionale;
- Baletet shqiptare.

- Tekste shkollore, literaturë shkencore dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.



## MUZIKA

- të demonstrojë njohuri të sakta dhe të qëndrueshme shkencërisht mbi muzikën dhe zhvillimin e tij;
  - të shpjegojë elementet dhe parimet e muzikës;
  - të japë udhëzime për krijimin e një eseje për një vepër muzikore ose veprimtarinë e një artisti;
  - të udhëheqë një projekt kërkimor për një periudhë të caktuar në historinë e muzikës (nga historia e muzikës botërore apo ajo shqiptare);
  - të shpjegojë ndërtimin e formave të ndryshme muzikore si klasifikimin e orkestrave:
    - *Orkestra simfonike*
    - *Kompleksi i dhomës*
    - *Banda;*
    - *Format muzikore 1, 2, 3pjesëshe:*
    - *Periudha muzikore*
    - *Minueti*
    - *Rondoja*
    - *Fuga*
    - *Sonata*
    - *Koncerti,*
    - *Simfonia.*
  - të shpjegojë vlerat e muzikës botërore dhe asaj shqiptare, duke përshkruar karakteristikat e secilës periudhë dhe përfaqësuesit e tyre:
    - *muzika në mesjetë;*
    - *muzika në Rilindje, përfaqësuesit dhe veprat e tyre.*
    - *muzika në klasicizëm, përfaqësuesit dhe veprat e tyre.*
    - *muzika romantike e shek. IX dheXX,*
    - *përfaqësuesit dhe veprat e tyre.*
  - të shpjegojë vlerat e muzikës shqiptare, duke përshkruar karakteristikat e secilës periudhë dhe përfaqësuesit e tyre:
    - *opera e parë,*
    - *baleti i parë,*
    - *simfonia e parë,*
    - *vepra të tjera të muzikës shqiptare.*
    - *muzika e lehtë dhe moderne: rrymat përfaqësuesit dhe veprat e tyre.*
- Tekste shkollore, literaturë shkencore dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.

<ul style="list-style-type: none"> <li>- muzika kosovare, karakteristika, vepra dhe përfaqësues.</li> <li>- kompjuteri dhe media të ndryshme në muzikë:</li> <li>- programi finale.</li> </ul>	
<p><b><u>TEATRI</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të demonstrojë njohuri të qëndrueshme dhe të sakta shkencërisht në fushën e estetikës, në përgjithësi dhe estetikës së teatrit, në veçanti;</li> <li>• të demonstrojë njohuri që njeh dhe përdor elementet dhe parimet e teatrit: <ul style="list-style-type: none"> <li>- publiku,</li> <li>- zhanret teatrale,</li> <li>- drama,</li> <li>- aktori,</li> <li>- regjisorin,</li> <li>- skena,</li> <li>- elementet vizive,</li> <li>- etj.</li> </ul> </li> <li>• të fitojë aftësitë e domosdoshme që të drejtojë procese të realizimit dhe të krijimit në fushën e mjeshtrisë së aktorit dhe fjalës artistike: <ul style="list-style-type: none"> <li>- ushtrime dhe lojra teatrale,</li> <li>- etyde,</li> <li>- tregimi,</li> <li>- poezia,</li> <li>- monologu.</li> </ul> </li> <li>• të prezantojë dhe përshkruajë saktë vlerat e teatrit botëror dhe përfaqësuesit e tij: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Origjina e teatrit</li> <li>- Teatri greko-romak i antikitetit</li> <li>- Komedia e artit</li> <li>- Teatri i Rilindjes Europiane</li> <li>- Teatri iluminist dhe romantik</li> <li>- Teatri realist</li> <li>- Tendanca të teatrit kontemporan etj.</li> </ul> </li> <li>• të japë udhëzime për krijimin e një eseje për një vepër të artit skenik ose veprimtarinë e një artisti;</li> <li>• të udhëheqë një projekt kërkimor për një periudhë të caktuar në historinë e teatrit (nga historia e teatrit botëror apo ajo shqiptare);</li> <li>• të prezantojë dhe përshkruajë saktë vlerat e teatrit shqiptar dhe përfaqësuesit e tij.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste shkollore, literaturë shkencore dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.</li> </ul>